



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 19 nëntor 2019.
2. Prezantimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
 - 2.1.Prezantimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.
 - 2.2.Njoftimi i draftit të ripunuar me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Adriatik Alimadhi, Aurora Mara, Elda Hoti, Elena Xhina, Ediola Braha, Edlira Bode dhe Artemis Dralo

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Adnor Shameti, Edmond Leka, Tom Doshi dhe Nikolin Staka

Të ftuar:

Fjoralba Caka – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e

Drejtësisë

Evis Fico – këshilltare e Ministrit të Drejtësisë

Irena Malolli – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Gentian Sala – Kryetari i AMA-s

Sara Xhumbari - Drejtoreshë e Drejtorisë Juridike dhe Licencave në AMA

Jetmir Braha – Drejtor i AKEP-it

Marsida Drushku – përfaqesuese nga drejtoria juridike në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Në fakt, sot do të kemi prezantimin në parim të dy projektligjeve shumë të rëndësishme, të cilat do të shqyrtohen në paketë në Komisionin e Ligjeve.

Janë prezantimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Në shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve, komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, relatorët e këtyre dy projektligjeve janë koleget Klotilda Bushka dhe Vasilika Hysi.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi ftuar zonjën Fjoralba Caka, zëvendësministre, zotin Besmir Beja, drejtor i Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit, nga AMA kemi të pranishëm Gentian Sala, kryetar i AMA-s dhe zonjën Sara Xhumbari, drejtoreshë e Drejtorisë Juridike dhe Licencave në AMA.

Përpara se t’ia kaloj fjalën zonjës Caka për të bërë një prezantim të të dyja projektligjeve, dua t’i bëj me dije anëtarët e komisionit, por edhe mediet e pranishme dhe opinionin publik, se sot do të kemi vetëm prezantimin e dy projektligjeve, nuk do të kemi votim në parim, sepse, siç jeni në dijeni, Komisioni i Ligjeve ka miratuar një kalendar të posaçëm për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre dy projektligjeve, kalendar i cili është publik në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë. Pas prezantimit të sotëm dhe deri në votimin e dy projektligjeve në parim e më pas nen për nen, do të ketë një seri dëgjesh me grupet e interesit.

Sigurisht draftet, që do të diskutohen me grupet e interesit pas prezantimit sot në parim, kanë pësuar ndryshime me ekspertizën me të mirë të ekspertëve ndërkombëtarë, por të dyja projektligjet janë diskutuar nën patronazhin e drejtpërdrejtë të ekspertëve të OSBE-së dhe të Komisionit të Ligjeve. Gjithsesi të dyja këto drafte janë të hapura për diskutim, sepse interesi ynë është të kemi dy ligje që janë brenda standardeve europiane në këtë fushë.

Unë pa humbur kohë dua t’ia kaloj fjalën zëvendësministres, zonjës Caka.

Fjoralba Caka – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Ministria e Drejtësisë është bashkëpropozuese për dy akte të rëndësishme ligjore me Ministrinë e Transportit dhe Energjetikës. Kemi të bëjmë me dy projektligje që adresojnë rregullimin e shërbimit mediatik në Shqipëri.

Kjo nevojë për të rregulluar medien dhe veçanërisht medien elektronike, apo shërbimet elektronike, është e konstatuar jo vetëm në vendin tonë, por është një tendence që po vihet re gjerësisht dhe në vendet e BE-së, në Kanada, SHBA-të dhe në Australi, pasi media elektronike është kthyer në një burim shumë të rëndësishëm të informacionit. Veçanërisht media elektronike, ndonjëherë kthehet në një burim keqinformimi prandaj ka nevojë të rregullohet e të normohet.

Shkurtimisht unë do të kaloj te qëllimet e ligjit, por për të sjellë në vëmendjen tuaj se sa i rëndësishëm është ky ligj, më lejoni të sjell një informacion nga një raport i *Freedom House*, ku keqinformimi apo *fake news* kanë ndikuar në zgjedhjet në të paktën në 18 shtete nga 65 të analizuara. Keqinformimi, ose lajmi i rremë, apo *fake news* po përbën një problem, jo vetëm për vendin tonë, por dhe për shumë vende të tjera dhe më e keqja është se keqinformimi, i cili përçohet nëpërmjet medieve elektronike, ndikon në proceset demokratike, veçanërisht në procesin elektoral, i cili është thelbi i demokracisë. Kjo është arsyeja pse ne vëmë re tendencën e përgjithshme për të rregulluar medien elektronike dhe shërbimet e ofrimit mediatik nëpërmjet këtyre medimeve.

Gjithashtu një element për të cilin media elektronike, apo ofruesit e shërbimeve mediatike elektronike kanë nevojë për rregullim, është ai i munitarizimit të lajmeve, veçanërisht lajmeve të rreme, sepse duke tërhequr klikime në portale të ndryshme njihet efekti i fitimeve financiare dhe kjo është arsyeja pse plani i veprimit për komunikimet elektronike dhe për keqinformimin i BE-së 2018 e përkufizon keqinformimin si shpërndarje të lajmeve të rreme, apo çorientuese me qëllim ose fitimin monetar ekonomik, ose nga ana tjetër, dëmtimin e publikut me qëllim, ku një prej arsyeve mund të jetë elementi i ndikimit në zgjedhje.

Patjetër që Shqipëria ka specifikat e saj që legjitimojnë nevojën për një ndërhyrje të tillë. Shumë nga portalet mediatike punësojnë persona dhe nuk i kanë të regjistruar ata, duke mos respektuar kontratën e punës, lejen vjetore dhe të gjitha të drejtat që Kodi i Punës u njeh personave, që ofrojnë një shërbim dhe patjetër kjo ka nevojë për rregullim.

Pra është e nevojshme që gazetarët, por edhe personat e tjerë që punojnë në portalet online, apo në ato që njihen si media *outlets*, të kenë një kontratë të rregullt pune dhe të jenë

subjekte edhe të regjistrimit tatimor në momentin që gjenerojnë të ardhura nëpërmjet klikimeve, apo reklamave.

Qëllimi tjetër i rëndësishëm i projektligjit është i lidhur me transparencën e pronësisë mbi medien. Ashtu siç është vënë re nga BE-ja, nga Këshilli i Europës dhe nga OSBE-ja, një pjesë e mirë e mediave, sidomos ato elektronike, duke mos e pasur të regjistruar portalin mund të ndikojnë në formimin e opinioneve publike, sidomos në rast se këto medie elektronike janë të përqendruara në një dorë të vetme, që mund të jetë një operator ekonomik, një biznes i fuqishëm, apo ndonjëherë një oligark. Kjo bën që i gjithë opinioni publik të ndikohet nga pjesa më e madhe e portaleve, e cila, në fund të ditës zotërohet nga një pronar i vetëm. Kjo është arsyeja pse direktiva e riparë e BE-së për mediet audiovizive të vitit 2018 e çmon të rëndësishëm regjistrimin dhe pasjen e transparencës lidhur me pronësinë mbi mediet, qoftë ajo tradicionale, lineare, qoftë jolineare, ku vetë konsumatori mund të zgjedhë produktin në bazë të një katalogu, apo, në rastin tonë, shërbimet elektronike, apo siç njihen ndryshe, portale *online*.

Patjetër që transparenca dhe njohja e pronarëve të medias është e drejtë e çdo qytetari. Çdo qytetar ka të drejtë të dijë se kush qëndron pas një portali dhe kjo i shërben atij jo vetëm për të dalluar larminë e informacionit që merr, por edhe për të mbrojtur të drejtën dhe dinjitetin e tij në momentin që ky cenohet.

Problemi në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, dhe që është shtruar si objekt për debat është raporti i mbrojtjes të së drejtës së informimit në lidhje me të drejtën e jetës private dhe familjare. Në rast se një portal nuk është i regjistruar, nuk e ka pronarin ose nuk ka një adresë specifike, në rast se ka nxjerrë një lajm të rremë, i cili ka dëmtuar rëndë dinjitetin, privatësinë apo të drejtën për jetë familjare që mbrohet edhe nga neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Themelore të Njeriut, kjo çon direkt në mundësinë që ai portal të paditet.

Duke regjistruar pronarin ne u japim mundësinë qytetarëve, që janë goditur nga një lajm i rremë të ngrenë padi. Kjo është për arsye të pastra ligjore procedurale, pasi të gjithë ne që jemi juristë jemi të vetëdijshëm që në momentin që ti nuk ke një adresë, një identitet të paditësit, atëherë edhe padija jote do të jetë me të meta dhe është e vështirë të ezaurosh në rrugë ligjore një të drejtë që ta garanton si kuadri ligjor kushtetues shqiptar, ashtu dhe kuadri ligjor ndërkombëtar, apo organizatat ndërkombëtare ku marrin pjesë veçanërisht KE-ja me Konventën Europiane për të Drejtat Themelore të Njeriut.

Një element tjetër pse është e nevojshme kjo ndërhyrje, lidhet edhe me besueshmërinë e informacionit. Unë jam e kënaqur që shoh të pranishme këtu shumë medie, sepse një pjesë e mirë e gazetarëve janë profesionistë, japin informacione cilësore të bazuara në fakte dhe

patjetër që besueshmëria i gazetarisë cenohet në momentin kur në portale të caktuara qarkullojnë lajme të rreme. Siç thotë dhe një autor, që kam lexuar së fundmi për sa i përket *fake news* dhe fenomenit në botë, media *online* i vihet ndonjëherë gazetarisë tradicionale dhe asaj të bazuar në fakte, por duke i cenuar pak dinjitetin, sepse e shtrembëron. Besueshmëria e informacionit është e rëndësishme pasi studimet tregojnë se nëse informacioni dhe gazetaria nuk bazohen në fakte, as qytetarët e përfshirë në debat nuk do të kenë me një debat të bazuar në fakte dhe debati, apo përfshirja e tyre nuk do të jenë vërtet të përfshirë në proceset ligjberëse, politikëberëse, të bazuar në fakte dhe në të vërtetën, por në lajme të rreme, gjë që konsumon kohën e tyre dhe patjetër nuk ndihmon demokracinë dhe pluralitetin e mendimit.

Kjo paketë ligjore synon të mbrojë të drejtën e autorit, apo të drejtën e pronësisë intelektuale, e cila garantohet nga kuadri ynë ligjor. Këto janë disa nga arsyet që legjitimojnë këtë ndërhyrje. Unë jam e vetëdijshme që ka pasur shumë debat për mënyrën si është parashikuar ndërhyrja në dy ligjet kryesore, atë të medieve audiovizive dhe të AEKP-it.

Meqë kemi publikun të pranishëm, doja t'ju sillja në vëmendje se në asnjë moment këto ndërhyrje ligjore nuk synojnë të kenë efekt frenues mbi gazetarinë, nuk është qëllimi të frenohen lajmet nëpërmjet portaleve, nuk është qëllimi të kontrollohet përmbajtja e tyre, por të shmanget keqinformimi, lajmi i rremë dhe të mund të kemi një rregullim aty ku tashmë nuk ka më rregull. Është pikërisht ky raporti i drejtë mes së drejtës së informimit dhe dinjitetit të njeriut që gjen vend edhe në kuadrin ligjor. Vetë neni 4 i këtij ligji jep një parim shumë të rëndësishëm kur thotë që asnjë dispozitë e këtij ligji nuk duhet të interpretohet në mënyrë në tillë që të cenojë të drejtën e informimit, apo të drejtën e një shtypi të lirë.

Për ta mbyllur, për sa i përket procesit, ai i është nënshtruar konsultimit gjatë periudhës dhjetor-janar. Ne, duke dashur të krijojmë një ligj dhe një kuadër ligjor që përputhet me standardet më të larta europiane, jemi këshilluar me OSBE-në dhe BE-në dhe kemi reflektuar të gjitha shqetësimet e tyre në këtë akt të ri që i është paraqitur Kuvendit. Pra, ka pasur ndryshime dhe përmirësime të draftit fillestar, duke reflektuar të gjitha komentet dhe standardet më të mira europiane për sa i përket shtypit të shkruar, lirisë së medias dhe të shprehjes.

Ky ishte një prezantim i shkurtër.

Nëse koleget nga AMA, apo dikush tjetër, dëshiron të plotësojë diçka, është i mirëpritur.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Besoj se prezantimi ishte për të dy projektligjet, sepse kanë ardhur në formë pakete.

U lutem relatorëve që të flasin shumë shkurt, sepse sot nuk do të hapim as pyetje as diskutime, është thjesht diskutim në parim, sepse do të ketë një seri dëgjësash me grupet e

interesit dhe shoqërinë civile, por edhe me shoqatat e medie, medieve online dhe me gazetarët, kështu që do të kemi mundësinë të bëjmë pyetje, diskutime dhe debate rreth dy projektligjeve deri në momentin kur t'i miratojmë në parim.

Po, zonja Bushka.

Ju lutem, shkurt!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me prezantimin e nismës falënderoj zonjën Caka! Besoj se ajo ishte e qartë dhe shteruese dhe nuk ka pse të ripërsëris, sepse jemi në të njëjtën linjë. Draftligjet e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Energjetikës, si nismë e përcjellë nga KM-ja, janë këshilluar në një grup punë të përbashkët me nismëtarëve, deputetëve relatorë të Komisionit të Ligjeve me ekspertët e OSBE-së. Gjithashtu janë konsultuar të gjitha aktet e KE-së në lidhje me çështje që prekin të dyja draftligjet.

Sot, të nderuar kolegë, ju informoj, por edhe publikun dhe grupet e interesit, që janë të interesuar për këto dy çështje, se do të merren si bazë për shqyrtimin e nismave draftet e rishikuara, të cilat përmbajnë dhe reflektojnë të gjitha këshillimet dhe konsultat e bëra me ekspertët ndërkombëtarë. Ne kemi miratuar një kalendar dëgjësash, i cili është në faqen *online* të Kuvendit dhe u është komunikuar të gjitha grupeve të interesit të regjistruara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë elektronike, duke i bërë me dije se cilat janë datat e dëgjësave publike në lidhje me të dyja projektligjet. U janë dërguar draftet e ripunuara që të kenë kohë të përgatiten për të ardhur në dëgjesa me komente dhe sugjerime konkrete.

Këto dy ligje u shërbejnë interesave të publikut, ne e dimë që funksioni i medias në një shoqëri demokratike është thelbësor dhe duhet patjetër të garantohet. Në të njëjtën kohë kjo garanci duhet balancuar me të drejtat e individëve për dinjitet, për jetë private dhe për të gëzuar të drejtat e tyre, ashtu si media duhet të gëzojë të drejtat e veta. Duke qenë se është një ligj për publikun ne kemi menduar dhe kemi miratuar një seri të gjatë dëgjësash me të gjitha grupet e interesit, të cilat do të fillojnë të hënën e javës që vjen, duke filluar me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet shtetërore dhe me operatorë mediatikë. Më pas do të kemi dëgjësë me organizatat e shoqërisë civile, me dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit, me botën akademike, me përfaqësues të gjyqësorit, prokurorisë dhe avokatisë dhe, në fund me shoqatat e medie, gazetarët dhe përfaqësues të medias së shkruar.

Jo pa qëllim është lënë në fund dëgjesa me grupin i cili ka ngritur shqetësime në lidhje me dy projektligjet, në mënyrë që të ezaurohen të gjitha çështjet në një kohë më të gjatë prej tyre, si dhe të dëgjohen të gjitha qëndrimet e grupeve të tjera, që kanë njësoj rëndësi si çdo grup tjetër. Prandaj ata që nuk e kanë pasur këtë informacion dhe janë të interesuar të marrin pjesë

në dëgjesa, mund të konsultojnë faqen e internetit dhe ne do t'i njoftojmë në mënyrë direkte nëpërmjet komunikimit elektronik, por jemi të hapur që edhe ata që nuk janë të regjistruar në portalin e Kuvendit, si grupe të akredituara të interesit, të jenë të pranishëm në dëgjesat, që do të zhvillohen nga Komisioni i Ligjeve.

Po e mbyll këtu dhe i uroj punë të mbarë komisionit në shqyrtimin e dy nismave shumë të rëndësishme, të cilat e kanë të bazuar thelbin e tyre jo vetëm në standardet më të mira ndërkombëtare, por specifikisht në të drejtën e BE-së që rregullon çështje të ngjashme dhe në rezolutat e Asamblesë Parlamentare të KE-së, konkretisht rezoluta e fundit nr. 2255e vitit 2019, që balancon garantimin e së drejtës së medias dhe shtypit të shkruar, me të drejtën e individëve për të pasur dhe gëzuar jetën private, të drejtën e privatësisë familjare, si dhe të drejtat e tjera të njeriut, që njihen dhe garantohen nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, për sqarimin e procedurës parlamentare për kolegët deputetë, por edhe për opinionin publik dhe mediet e pranishme në sallë!

Draftet që u prezantuan sot janë në faqen zyrtare të Kuvendit, janë në variantin fillestar, siç i ka sjellë qeveria të publikuara, sepse kjo është pjesë e procedurës parlamentare, ndërsa organizatave të listuara nga zonja Bushka, të cilat do të jenë në dëgjesë publike javën që vjen, u kanë vajtur draftet e ripunuara të ekspertëve. Të jemi korrektë me sqarimin e procedurës parlamentare dhe diskutimi që do të bëhet javën e ardhshme, do të jetë mbi bazën e drafteve që keni marrë, pra qëllimi final është që përpara votimit në Komisionin e Ligjeve dhe më pas në seancë plenare, ne të kemi variantet e konsoliduara dhe të integruara të të dyja projektligjeve. Është e rëndësishme që për të dy këto projektligje Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi i Shqipërisë kanë vullnetin e duhur për të dëgjuar deri në fund grupet e interesit. Në fund të fundit, e theksoi si zonja Caka, ashtu dhe kolegja Bushka, interesi final dhe qëllimi i të dy projektligjeve është balancimi i të drejtave në një shoqëri demokratike dhe të hapur. Sigurisht që ligji garanton të gjitha ato që u thanë, pra të drejtën e informimit, të drejtën e autorit, besueshmërinë e gazetarisë dhe të lajmit, por në fund, në një shoqëri të hapur dhe demokratike ka të drejta dhe detyrime.

Këto dy projektligje, në harmoni të plotë edhe me legjislacionin bashkëkohor europian do të duhet të garantojnë një balancë të të drejtave dhe detyrimeve, që çdo qytetar ka në një shoqëri demokratike.

Shumë faleminderit, zonja Caka për prezantimin, falënderoj edhe zotin Sala, kryetari i AMA-s, për praninë!

Faleminderit kolegëve, gazetarëve dhe medieve të pranishme për transparencën e kësaj seance të mbledhjes së Komisionit të Ligjeve! Ju ftoj që me të njëjtin intensitet që përcillni mbledhjet e Komisionit të Ligjeve për projektligje të ndryshme, javës tjetër dhe deri sa të votojmë në parim dhe nën për nën dy projektligjet, të bëheni dhe pjesë e diskutimeve dhe e dëgjësave tona, se në fund të fundit, këto dy projektligje prekin drejtpërdrejt punën tuaj.

Shumë faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA